

RAPORTI
VJETOR

2021

investo ně optimizēm

abi AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

4	Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv
6	Qeverisja e Korporatës
8	Strukturë Organizative
10	Burimet Njerëzore
14	Korporatat
16	Njësia e Operacioneve
18	Njësia Bankare Retail
22	Përgjegjësia Sociale
28	Rrjeti i Degëve dhe ATM

Mesazh i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv

Andi Balta

Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

Dua të falenderoj dhe përgëzoj gjithë personelin e ABI Bank për rezultatet e vitit 2021, që shënon një tjetër vit rekord në gjithë treguesit kryesorë pavarësisht nga sfidat e pandemisë. Stabilizimi i situatës financiare të klientëve tanë nga pandemia gjatë vitit 2020 ishte objektivi kryesor i bankës. Ky objektivi u realizua dhe u tejkalua në mënyrë të shkëlqyer nga një bashkëpunim i ngushtë midis bankës dhe klientëve.

Në kontekstin e pandemisë, kur shumë prej nesh dhe klientëve tanë patën një stres shoqëror, financiar dhe shëndetësor jemi shumë krenar për këto rezultate.

ABI vazhdon të raportojë një rritje të fortë të portofolit në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke optimizuar në mënyrë të vazhdueshme bazën e klientelës, raportin e fitimit dhe riskut, dhe ndërtimin e një portofoli të diversifikuar në klientë dhe industri pa humbur ndjesinë e konceptit butik.


Ky koncept vazhdon të jetë në thelb të kulturës te ABI dhe ne synojmë të thellojmë dhe përsosim marrëdhënien tonë 360 gradë me një klientelë që përzgjidhet në mënyrë konstate.

Shumë nga kompanitë më të njohura në vend punojnë me ABI për të përfituar shërbim të gjerë, korrektesë, shpejtësi dhe cilësi. Si çdo shërbim butik, ABI është i dedikuar të jetë pranë klientëve që aktivitetin e tyre nuk e kanë "bulevard vetëm me semaforë jeshilë". Përkundrazi, përkushtimi i ABI ndaj klientelës në momente të vështira është ajo çfarë na ka dalluar dhe do vazhdojë të na dallojë. ABI nuk është në biznesin e mënjanim të rreziqeve, por të manaxhimit të rreziqeve.

Si paraqitet në tabelën më poshtë gjatë vitit 2021 janë rritur aktivet totale të bankës, kapitali, depozitat, portofoli i kredive, dhe fitimi. Jemi vecanërisht krenarë për përmirësimin e raportit të kredive të këqija në nivelin e sektorit bankar.

INDIKATORËT KRYESORË	2021 (EUR MILIONË)	2020 (EUR MILIONË)	2021 VS. 2020
Aktivet totale	815	704	↑ +15.8%
Depozita totale	598	551	↑ +8.5%
Kredia neto	297	237	↑ +25.3%
Investimet në Letra me vlerë	359	284	↑ +26.4%
Kapitali	87	83	↑ +4.8%
Fitimi neto pas taksave	11.5	8.6	↑ +32.6%
Raporti i kredive të këqija	4.6%	12.1%	↑ -62%

Qysh prej krijimit të ABI, rritja e aktiveve, kapitalit dhe fitimit ka qenë konstate dhe e ka pozicionuar ABI si leader të sistemit bankar.



Mbi të gjitha, raportet e fitimshmërisë janë konsoliduar në nivelin dy shifror në vitet e fundit.



Sot Shqipëria dhe shoqëria shqiptare janë pjesë e një bote globale falë zhvillimeve teknologjike dhe shoqërore të 30 viteve të fundit. Është e drejtë dhe e domosdoshme që klientela shqiptare të përfitojë nga ky globalizim dhe zhvillim teknologjik shumë më shumë se përpara. ABI mendon se zhvillimi 30 vjeçar i ekonomisë shqiptare ka sjellë shumë më shumë pasuri në vend nga sa ka patur informacion, mentorim dhe kulturë investimi. Për rrjedhojë një pjesë domethënëse e kësaj pasurie vazhdon të mbetet e pashfrytëzuar lokalisht dhe globalisht. Pozicionimi i shumicës së klientelës së sistemit bankar në Shqipëri vazhdon të jetë në para, prona të patundeshme apo kompani të kontrolluara në mënyrë familjare. Ky pozicionim ka qenë i saktë por jo domosdoshmërisht siguron maksimizim të fitimit në kohë të mira apo mbrojtje nga situata ekstreme. Edukimi i klientelës në potencialin e rritjes së kujdesshme, të matshme, dhe të mirëkontrolluar së kësaj pasurie individuale apo korporative në mundësi lokale dhe globale, është një nga sfidat e të ardhmes për ABI.

Këshilli Drejtues

Kathryn Swintek

Kryetare e Këshillit Drejtues
(Anëtare e Pavarur)

Roberto Munoz

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtar i Pavarur)

Ernst Schlauch

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtar i Pavarur)

Kristin Giantris

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Anëtare e Pavarur)

Armand Muharremi

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor i Divizionit të Financës)

Brunilda Papa

Anëtare e Këshillit Drejtues
(Drejtoreshë e Njësisë së Operacioneve)

Andi Ballta

Anëtar i Këshillit Drejtues
(Drejtor Ekzekutiv i Përgjithshëm)

Banka Amerikane e Investimeve sh.a., ka miratuar Kodin e Qeverisjes Korporative, i cili është në përputhje me Statutin e Bankës dhe legjislacionin në fuqi.

Kjo rregullore përfshin rregullat e brendshme të Bankës, parimet dhe mekanizmat e kontrollit në bazë të të cilave, Banka organizohet dhe menaxhohet, duke miratuar një strukturë e cila është transparente për investitorët, duke njohur dhe respektuar të drejtat e klientëve dhe duke siguruar interesat legjitime të aksionarit të vetëm të Bankës. Parimet bazë të Kodit të Bankës mbi Qeverisjen Korporative, përshkruhen në vijim:

1.1. Të drejtat e aksionarit

Banka ka vendosur rregulla, që garantojnë për aksionarin marrjen e informacionit të plotë mbi kushtet financiare të Bankës, si dhe mbi vendimet e Menaxhimit që ndikojnë ndjeshëm në veprimtarinë e saj. Aksionari i vetëm është një organ vendimmarrës, i cili ushtron autoritetin e tij në përputhje me Statutin e Bankës, Kodin e Qeverisjes Korporative dhe dispozitat ligjore në fuqi.

1.2. Përbërja e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues përbëhet nga shtatë anëtarë ekzekutivë dhe joekzekutivë (të pavarur), në

përputhje me kërkesat e Ligjit për Bankat në Shqipëri. Diversiteti në arsim, përvojë dhe në fushat e ekspertizës së anëtarëve të Këshillit Drejtues, është një faktor kyç në drejtimin e një banke butik.


1.3. Detyrat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues është një organ vendimmarrës, i cili i përgjigjet drejtpërdrejt aksionarit të vetëm. Këshilli Drejtues në përputhje me Statutin e Bankës dhe Kodin e Qeverisjes Korporative, përcakton vizionin, misionin dhe strategjinë e Bankës. Qëllimi kryesor i Këshillit Drejtues, është të sigurojë veprimtari të shëndetshme të kompanisë, duke ndjekur rritjen afatgjatë të vlerës ekonomike të saj, duke monitoruar, drejtuar dhe kontrolluar ekzekutivin në përputhje me interesat e aksionarit.

1.4. Kontrolli i Brendshëm

Banka ka një divizion të organizuar të Kontrollit të Brendshëm, të mbikëqyrtur nga Komiteti i Kontrollit të Bankës. Ky i fundit, në përputhje me kërkesat ligjore, përbëhet nga tre anëtarë të pavarur, ekspertiza dhe monitorimi i të cilëve, është një ndihmë e vlefshme dhe e vazhdueshme për Bankën. Kryetari i Komitetit të Kontrollit është njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues.

Struktura Organizative





Punonjësit në ABI

Me një staf prej mesatarisht 360 punonjësish, ABI Bank synon të jetë një punëdhënës, që garanton dhe angazhohet maksimalisht në krijimin e një mjedisi konkurrues për sa i përket kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit.

Vetë qëllimi i punës në Divizionin e Burimeve Njerëzore, është krijimi dhe ruajtja e një ambienti pune tërheqës dhe profesionalisht stimulues.

Si gjithmonë, stafi vijon të jetë pika jonë më e fortë. Veçanërisht gjatë vitit 2021, ku situata gjatë pandemisë vazhdonte të ishte aspak e zakonshme, punonjësit tanë kanë treguar aftësi dhe përpjekje të forta për të përmbushur standardet dhe objektivat e përcaktuara, si dhe për të realizuar në kohë e me sukses objektivat e Bankës.

Viti 2021 thelloi fokusin e ABI-t si një bankë butik. Kjo është shumë e rëndësishme të kuptohet, jo si tendencë e momentit, por si stil jete, që do të vazhdojë përgjithmonë në ABI. Kultura butik është plani ynë afatgjatë.

Gjithashtu, politikat e bankës për punësim dhe trajtim në mënyrë të barabartë, u kanë mundësuar 49 punonjësve të gjejnë punë afatgjatë apo afatshkurtër brenda institucionit tonë, duke siguruar procese rekrutimi të suksesshme.

Edhe pse në kushtet e distancimit fizik, të gjitha proceset e rekrutimit janë zhvilluar normalisht, në funksion të përzgjedhjes të kandidatit më të mirë të mundshëm, me qëllimin përfundimtar rritjen cilësore të kapaciteve të Burimeve Njerëzore.

Në kuadër të nxitjes dhe inkurajimit të imazhit të gjithsecilit, duke nisur nga data 1 maj 2021, në ABI aplikua një kod veshjeje më fleksibël, duke dashur t'i japim përparësi lehtësimit dhe rehatisë së punonjësve dhe krijimin e një ambienti sa më miqësor.

2

Menaxhimi i situatës gjatë pandemisë

Objektivi kryesor i punës së Divizionit të Burimeve Njerëzore gjatë vitit të vështirë 2021, ka qenë shëndeti i punonjësve tanë. Divizioni i Burimeve Njerëzore, si aktor kryesor i grupit të menaxhimit të krizave, ka ndjekur dhe monitoruar planet e detajuara të punës lidhur me menaxhimin dhe mbarëvajtjen e detyrave për secilin funksion, raportimin e rasteve COVID-19 dhe masat që duheshin ndërmarrë në çdo rast specifik. Në mënyrë të vazhdueshme janë dërguar te i gjithë stafi, udhëzime bazuar në direktivat e OBSH-së, Komitetit Teknik, Ministrisë së Shëndetësisë, Komitetit të Burimeve Njerëzore të Shoqatës së Bankave, në lidhje me masat dhe kujdesin personal që duhet të tregojë çdo punonjës.

Janë menaxhuar Planet Remote dhe prania në punë e stafit, si dhe lejet vjetore në kushte pandemie. Janë monitoruar ngushtësisht dhe ndjekur vazhdimisht të gjitha situatat apo problematikat e raportuara nga stafi, duke pasur në qendër të vëmendjes dhe në kujdes të veçantë grupet më të ndjeshme (koleget shtatzëna, apo me sëmundje kronike). Divizioni i Burimeve Njerëzore ka qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe është kujdesur për mbarëvajtjen e situatës shëndetësore të kolegëve të prekur nga Covid-19, duke bërë të mundur mosreflektimin e rastit në punën e përditshme. Në lidhje me sa më lart, në muajin qershor, kolegëve të interesuar u është ofruar mundësia e vaksinimit ndaj COVID-19, me vaksinat Sputnik dhe Sinovak.

Funksione e aktivitete të BNJ-së dhe rikthimi në normalitet



Një tjetër proces i rëndësishëm, sa kërkues aq edhe sfidues duke pasur parasysh situatën në lidhje me pandeminë, ishte edhe organizimi, zhvillimi dhe monitorimi i trajnimeve për stafin.

Pas identifikimit të kërkesave të biznesit dhe nevojave të stafit për trajnim, janë propozuar trajnime në përmbushje të këtyre nevojave. Edhe pse në një situatë jo të favorshme, janë organizuar dhe koordinuar trajnime të jashtme dhe të brendshme (më së shumti online, në respekt të protokolleve të sigurisë dhe rregullave në fuqi), duke bërë të mundur sjelljen e një produkti përfundimtar cilësor dhe brenda standardeve të kërkuara, detyrimeve ligjore apo rekomandimeve të lëna.

Gjatë situatës së pandemisë, u arrit përshtatja duke kaluar në formatin online të trajnimeve, gjithashtu u krijuan të gjitha mundësitë për pajisjen e të gjithë punonjësve me të gjitha mjetet e nevojshme për këtë realitet të ri. Gjatë vitit 2021, janë organizuar 1445 ditë trajnime dhe 100% e stafit ka marrë pjesë minimalisht në 4 sesione trajnime.

Në qendër të vëmendjes gjatë vitit 2021, kanë qenë gjithashtu, rishikimi i procedurave të BNJ-së dhe Manualit të Punonjësve në kuadër të përmirësimit të proceseve dhe politikave. U rishikuan, u aprovuan dhe u publikuan një pjesë e madhe e politikave të divizionit të Burimeve Njerëzore në kuadër të përmbushjes së strategjive dhe të arritjes së objektivave të Bankës Amerikane të Investimeve.

Pas periudhës së vështirë që kaluam, me ndryshimin e padiskutueshëm të përparësive dhe mënyrës së të jetuarit, sfida e rikthimit në normalitet, është sigurisht ajo më e vështira. Pikërisht, në kuadër të rikthimit në normalitet, kemi organizuar ngjarje dhe aktivitete, si: festa e Shën Patrikut, festa e 4 Korrikut, festa e 1 Qershorit, Halloween-i, dhe janë ndjekur netët e ndeshjeve gjatë kampionatit evropian në tarracën e ABI-t.

Gjithashtu, për çdo premierë apo shfaqje në TKOB, ABI ka ofruar bileta për stafin e interesuar, si sponsor në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit.



Respektimi i diversitetit dhe të dhënat e fundit të BOD-it për gjininë

Banka i konsideron punonjësit e saj si një faktor kyç suksesi për të arritur modelin e saj të biznesit. Për këtë arsye, Banka Amerikane e Investimeve siguron që çdo punonjës të trajtohet në mënyrë të drejtë, të barabartë, me dinjitet dhe respekt. Divizioni i Burimeve Njerëzore, brenda fushës së tij të veprimit dhe kontrollit, garanton një angazhim maksimal në trajtimin në mënyrë të drejtë dhe të barabartë të individëve, duke mos lejuar diskriminimin në asnjë moment gjatë të gjitha fazave të punësimit në ABI.

ABI u jep mundësi të barabarta të gjithë kandidatëve dhe punonjësve, pavarësisht nga mosha, gjinia, gjendja martesore, shtatzënia, statusi familjar, aftësia e kufizuar, raca, kombësia ose feja.

Banka Amerikane e Investimeve është ndër të vetmet banka në sistemin bankar, bordin e së cilës e drejton një anëtare femër. Gjithashtu, koleget femra përbëjnë 70% të forcës punëtore të ABI Bank dhe 57% për sa i takon linjës së parë të menaxhimit.



Korporatat

Viti 2021, ka vijuar të jetë një vit suksesi për ABI Bank, sidomos referuar biznesit të Korporatave dhe financimit të projekteve të ndryshme, të reja dhe në proces. Përveç mirëmbajtjes së marrëdhënieve ekzistuese me klientët korporativë, ne gjithashtu zgjeruam edhe bazën e klientëve tanë, duke ofruar mbështetje financiare dhe shërbim 360 gradë ndaj klientëve tanë.

Për të disatin vit radhazi, ABI Bank rikonfirmoi në treg pozicionin e saj si një nga bankat që vijon me rritje të lartë në sektorin bankar në Shqipëri. Rritja e kreditimit në fund të vitit 2021, ka qenë 22% më shumë se viti 2020, shifër kjo shumë herë më e mirë se rritja në total e kreditimit nga bankat rreth 8-9% në vit. Të qenët një bankë butik, i jep mundësi ABI Bank, të jetë shumë pranë interesave dhe nevojave të veçanta të klientëve. Fokusi ynë te klientët dhe përparësia që u japim klientëve, ka mundësuar që ABI Bank të përfaqësojë rreth 6% të tregut të kredive për vitin 2021.

Pavarësisht kufizimeve në sektorët ekonomikë dhe situatës pandemike, që ndikuan në standardet dhe kërkesat e kreditimit, ABI Bank ka vijuar të mbështesë biznesin në çdo moment. Një pjesë e rritjes së kredisë, u mbështet edhe nga skema e Garancisë Sovrane të Qeverisë Shqiptare, duke lehtësuar kërkesat për financim, kolateral etj... ABI Bank gjatë kësaj periudhe të vështirë, mbështeti me financime afatgjata bizneset që u prekën më shumë, me kredi për investime dhe kapital qarkullues.

Gjatë vitit 2021, janë disbursuar mbi 112 milionë euro në 150 kompani, korporata dhe SME, duke rritur portofolin e korporatave mbi 45% krahasuar me vitin 2020. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë, tregojnë se kredia e re për ekonominë paraqitet me rritje, duke rritur kreditimin e ri me rreth 5,5% krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që ne si ABI Bank kemi rritur kreditimin e ri për klientët e Biznesit, më shumë se 60% krahasuar me vitin 2020.

Në fund të vitit 2021, portofoli i kredive konsistonte në mbi 500 kompani në të gjitha industritë dhe fushat e biznesit, që dëshmon një shumëllojshmëri të klientelës dhe sektorëve. Nga këto, rreth 70 klientë të rinj i janë shtuar Bankës vetëm gjatë vitit 2021.

ABI Bank vijon të jetë përzgjedhëse dhe e detajuar në analizën e sektorëve të ekonomisë, si dhe të klientëve korporativë, në mënyrë që të ketë një portofol me cilësi të lartë. Kjo rikonfirmohet edhe me rezultatin financiar të fundit të vitit 2021, ku përqindja e kredive të këqija, është përmirësuar ndjeshëm dhe është në nivelet e bankave më të mira në treg. Norma e kredive të këqija (NPL ratio), ka pasur një përmirësim gjatë vitit 2021 në 4,7%, nga rreth 12,1% që ka qenë në vitin 2020.

Njësia e Operacioneve

Sfida e vitit 2021 - Projekte Kombëtare dhe përmirësim i Banking-ut Digjital

Gjatë vitit 2021, Njësia Operative ka marrë nismën dhe ka përbushur disa projekte me synim përmirësimin e shërbimeve dhe automatizimin e shumë proceseve.

Aktiviteti kryesor i Divizionit të Teknologjisë së Informacionit, është përqendruar në përbushjen e Projektit Madhor për Përmirësim të Sistemit Qendror Bankar (Oracle – Flexcube), me përfshirjen e të gjitha njësive biznes dhe operative në një proces të gjerë për përgatitjen e kërkesave për përmirësim të proceseve dhe funksionaliteteve, testimin, dokumentimin, trajnimin dhe përshtatjen e gjithë stafit në version të ri. Projekti është duke vijuar gjatë vitit 2021 dhe planifikon kalimin drejtpërsëdrejti gjatë vitit 2022.

Versioni i ri i sistemit Qendror Bankar, përveç përmirësimeve në shërbimet ndaj klientit dhe rritjes së efektshmërisë operative, do të vendosë bazat për zhvillimet e reja në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të Banking-ut Digjital, përbushjeve të Open Banking (PSD2) etj...

Gjithashtu, ky divizion ka vijuar me investime të rëndësishme në rritjen e kapaciteteve të Infrastrukturës ICT dhe atyre zhvilluese në shërbim të kërkesave të biznesit, si dhe atyre rregullatore. Këto investime, nga njëra anë kanë siguruar mbështetje dhe efektshmëri të qëndrueshme teknologjike të rritjes së aktivitetit të biznesit dhe atij operativ bankar. Nga ana tjetër, është realizuar zhvillimi in-house i raportimeve rregullatore në kuadër të projekteve të Fiskalizimit dhe Regjistrimit të Llogarive, zhvillimi i aplikacioneve të reja (Safe Box, Customer Satisfaction Monitoring etj...) dhe i përmirësimeve në aplikacionet ekzistuese ICT (Core Banking, Cards Application etj...).

Njësia Operative përfundoi me sukses projektin e prezantimit të platformës së Mobile Banking dhe përmirësimin e platformës Web Banking. Ky kanal banking-u, mundëson klientin me akses në "dorën e tij" të produkteve që mban në Bankën ABI, me

shërbime më të shpejta, më efikase dhe me nivelin maksimal të sigurisë sipas direktivës evropiane (PSD2).

Investimet dhe përmirësimet e Kartave ABI, vijuan edhe në vitin 2021, duke përfshirë elemente të reja sigurie, siç mandaton partneri ynë VISA.

Gjatë vitit 2021, Divizioni i Administratës dhe Prokurimeve, përfundoi me sukses Arkivin Qendror të Bankës, të projektuar në standard cilësor, i cili përmban në mënyrë të sistemuar të gjithë dokumentacionin historik bankar. Arkivi Qendror ndodhet në ambiente të organizuara në kushte të larta sigurie, të mbrojtura me sisteme sigurie dhe kontroll të aksesit, ku dokumentacioni është i sistemuar, i etiketuar dhe i regjistruar në mënyrë elektronike, për gjurmim të thjeshtë. Krijimi i arkivit të qendëruar, vjen si një zgjidhje për optimizimin e hapësirave të arkivave lokale të bankës dhe menaxhim efikas të aksesimit të dokumentacionit.

Gjatë vitit 2021, Departamenti i Sigurisë së Informacionit ka përforcuar vazhdimisht sigurinë ndaj sulmeve kibernetike, duke integruar teknologjitë më të fundit të mbrojtjes. Kujdes i veçantë është treguar ndaj monitorimit të tendencave të fundit të përdorura nga sulmuesit kibernetikë dhe ndaj përditësimit të strategjisë së sigurisë kibernetike të bankës.

Për të siguruar trajtimin e duhur të informacionit në ambientet e punës, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e punonjësve ndaj sigurisë kibernetike, punonjësit janë trajnuar vazhdimisht mbi çështjet e sigurisë së informacionit, përfshirë rreziqet e reja kibernetike.

Banka përfundoi shumë projekte të kërkuara nga entet qeverisëse dhe rregullatore, si: Krijimi i Regjistrimit Qendror të Llogarive Bankare, Ligji për Fiskalizimin, Shlyerje në AIPS për pagesat vendase të klientëve në euro.



Njësia Bankare Retail

Përmbushja e rrjetit të degëve gjatë vitit 2021, rezultoi e kënaqshme me objektivin për rritjen e depozitave, që u tejkalua në të njëjtën kohë që u arrit edhe një ulje e kostos totale të fondeve. Edhe aktiviteti kredihënës ishte pranë nivelit të synuar, pavarësisht një ambienti konkurrues domethënës, sidomos në aspektin e normave të interesit. Në vijim të konsolidimit të rrjetit të degëve dhe ATM-ve gjatë periudhës 2019-2020, viti 2021 ishte vit me fokus parësor rritjen e nivelit të kreditimit dhe bazës së depozituesve dhe kjo sfidë u përballua me sukses nga stafi i degëve dhe ekipi drejtues.

Gjatë vitit 2021, pati ndryshime në filozofinë e aktivitetit të gjenerimit të biznesit në aspektin e kredihënies. Përveç shërbimit dhe shitjeve tradicionale në segmentin Retail, degët zgjeruan njohjen me bizneset lokale dhe mundën që të prezantonin klientë cilësorë me nevoja specifike kreditimi në segmentin e bizneseve të mesme dhe korporatave.

Plotësimi i aktivitetit të Retail me referime biznesi, ka sjellë një rritje të sinergjisë dhe shtim të përfitueshmërisë së Rrjetit të Degëve.

Në mënyrë specifike në aktivitetin e kredisë, rrjeti i degëve ka arritur të gjenerojë një volum total kredish të reja prej 36,5 milionë eurosh. Sa i përket depozitave, besimi në rritje i bazës së klientëve depozitues i kombinuar me disa produkte novatore dhe stafin tonë të përkushtuar, prodhuan një rritje prej afro 40 milionë eurosh.

Risi për vitin 2021, përveç produkteve promovionale të depozitave, ishin edhe produktet alternative si fondet e investimit në monedhë lokale dhe të huaj. Në frymën e bankës së investimeve, këto fonde u krijuan për t'i dhënë më shumë mundësi diversifikimi dhe maksimizim të nivelit të kthimit, klientëve ekzistues dhe atyre të rinj. Vlen për t'u theksuar se këto produkte ishin plotësuese ndaj depozitave dhe nuk kanë penguar që banka të mbajë të njëjtën pjesë tregu të depozitave për individë si një vit më parë.

Në linjë me zhvillimet teknologjike të tregut dhe kërkesës së klientëve, u përmirësua me funksionalitete të reja shërbimi Online Banking dhe u hodh në treg për herë të parë aplikacioni ABI Mobile Banking.



Përgjegjësia Sociale

Banka Amerikane e Investimeve, e konsideron Përgjegjësinë Sociale të Korporatës, si një pjesë të rëndësishme të kulturës korporative, duke ofruar një angazhim të vazhdueshëm në programe sociale, shëndetësore, nisma për mbrojtjen mjedisore, që kanë si qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit ku kryejmë aktivitetin e biznesit tonë.

Gjatë vitit 2021, me vazhdimin e pandemisë COVID-19 në Shqipëri, ne kemi dëshmuar se jemi një biznes i përgjegjshëm, duke i kushtuar një kujdes të veçantë komuniteteve dhe grupeve në nevojë.

ABI Bank dhe stafi i saj i angazhuar në mënyrë vullnetare, u janë përgjigjur me përgjegjësi dhe ndjeshmëri të lartë kërkesave për ndihmë të familjeve në kushte të varfërisë ekstreme, duke ofruar rreth 1,4 ton produkte ushqimore. Bazuar në barazinë gjinore si një ndër përparësitë tona, kemi vazhduar të mbështesim projekte dhe aktivitete të drejtuara nga femrat, që synojnë barazinë për disa grupe të nënpërfaqësuar, të tilla si gratë e dhunuara dhe të trafikuar, duke përkrahur strehëzat si qendra të kujdesit dhe riintegrit të tyre në shoqëri.

Gjithashtu në qendër të vëmendjes sonë, ka qenë ajo pjesë e shoqërisë që është e izoluar dhe e cenuar nga pabarazia social-ekonomike, ku kemi vlerësuar si kontribut të rëndësishëm, plotësimin e nevojave jetike dhe ndryshimin e cilësisë së jetës.

Objektivi

1

Eliminimi i varfërisë në të gjitha format.



ABI Bank ka mbështetur nismën e fondacionit Çelësi Im "Këpucët e Krishtlindjes"

Në prag të festave të fundvitit, Banka Amerikane e Investimeve i është bashkuar nismës së ndërmarrë nga Fondacioni Çelësi Im, "Këpucët e Krishtlindjes". Në kuadër të këtij projekti u dhuruan 100 palë këpucë për fëmijë të familjeve në nevojë, të zonave të thella të qyteteve Shkodër, Korçë dhe Lushnjë.

Zero Uri

Objektivi

2

ABI Bank mbështet Food Bank Albania në "Solidaritë kundër urisë"

Stafi i ABI Bank dhe ABI Invest, në prag të festave të fundvitit, ndërmori nismën vullnetare të dhurimit të produkteve ushqimore, në bashkëpunim me FOOD BANK ALBANIA, në mbështetje të 56 familjeve shqiptare në nevojë.



ABI Bank mbështet fushatën "Ndërtimi i së ardhmes"

ABI Bank bëhet pjesë e fushatës së ndërmarrë nga Fondacioni Global Shqiptar gjatë muajit qershor "Ndërtimi i së Ardhmes". Kjo nismë, do të ofrojë mbështetje për gjashtë OJF të përzgjedhura, pjesë e shoqërisë civile, me në fokus programet për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri. ABI Bank ofroi mbështetje për Fondacionin Mirësia, në pajisjen me syze optike ndaj disa fëmijëve jetimë në qytetet: Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Korçë dhe Sarandë.



Shëndet i mirë dhe mirëqenie

Objektivi

3

Mjete për fëmijët me aftësi të kufizuara
Për një fëmijeri me dinjitet



ABI Bank mbështet World Vision Albania në programin "Tungjatjeta jetë"

Banka Amerikane e Investimeve mbështet World Vision Albania në programin "Tungjatjeta Jetë", në ndihmë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Bashkinë Lezhë dhe Njësitë Administrative Balldre, Blinisht, Dajç, Kallmet, Zejmen, Kolsh, Shëngjin. Projekti synoi fuqizimin e shërbimeve terapeutike në banesë, nëpërmjet pajisjes me materiale didaktike, si mekanizma të rëndësishëm në zhvillimin psikologjik dhe fizik të fëmijëve. Përgjegjshëm në raport me shoqërinë e komunitetin në shërbim të të cilit është.



ABI Bank mbështet fushatën e YWCA Albania "së bashku për fjonon rozë"

Banka Amerikane e Investimeve mbështet për të pestin vit radhazi YWCA of Albania, në nismat për ndërgjegjësimin dhe parandalimin e kancerit të gjirit. Nën moton "Fjongoja rozë na kujton se zbulimi i hershëm i kancerit të gjirit, na shpëton jetën", YWCA çel fushatën e 13-të të saj me ambasadore të kauzës, sopranon me famë botërore, Ermonela Jaho. Në datën 15 tetor, ABI Bank si sponsor platin, i është bashkuar ecjes simbolike të organizuar në qytetin e Tiranës.

Objektivi

4

Arsim
Cilësor

ABI Bank dhuron çanta, mjete shkollore dhe tabletë për Kryqin e Kuq shqiptar

Në prag të fillimit të vitit të ri akademik, Banka Amerikane e Investimeve mbështeti nismën e ndërmarrë nga Kryqi i Kuq Shqiptar, për të dhuruar çanta shkollore, mjete mësimore dhe tabletë për 50 fëmijë nga familje në nevojë të rrethave të qytetit të Tiranës.

Objektivi

5

Barazi
Gjinore

ABI Bank mbështet "Strehëzën për gra dhe vajza" në Tiranë

Banka Amerikane e Investimeve, në vijim të mbështetjes së organizatave që promovojnë barazinë gjinore, ka mbështetur "Strehëzën për Gra dhe Vajza" në Tiranë. Projekti synoi përmirësimin e mjedisve fizike dhe pajisjen me materiale për Terapi Arti, për të garantuar një cilësi shërbimi më të mirë për gratë dhe fëmijët e tyre, viktimat të dhunës në familje.

ABI Bank mbështet ankandin e dhurimit drejtpërdrejtë "R rathë dhurues, 2021"

Më 24 qershor, u organizua nga Partnerët Shqiptarë për të dytën herë, Ankandi i Dhurimit drejtpërdrejtë "Rrathë Dhurues, 2021". Qëllimi i kësaj veprimtarie, ishte promovimi dhe zhvillimi i filantropisë në Shqipëri, duke ofruar mbështetje financiare për tre kauza, që do të transformojnë jetën dhe do të sjellin ndryshime të qëndrueshme sociale për komunitete në nevojë. Kjo veprimtari mbledhi së bashku përfaqësues të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, sektorit shtetëror, shoqërisë civile, medias dhe artit.

ABI Bank ofroi mbështetje për dy prej iniciativave të prezantuara: Iniciativa e parë do të synojë përmirësimin e jetës së 126 fëmijëve të komunitetit "Lanabregas" në Tiranë, nëpërmjet ofrimit të një këndi lojrash të munguar, në përbushje të të drejtës së tyre për t'u argëtuar dhe shoqëruar. Iniciativa e dytë do të mundësojë për 15 familje në vështirësi ekonomike me nga 3-5 fëmijë, në zonën e Tufinës në Tiranë, nga një kënd studimi në banesat e tyre, si dhe mjetet e duhura shkollore.

Art, Sport, Kulturë



FESTIVALI KULTUROR SHQIPËRI - IZRAEL

Banka Amerikane e Investimeve sponsor i përgjithshëm i Festivalit Kulturor Shqipëri-Izrael, i cili festoi lidhjet historike dhe kulturore ndërmjet Izraelit dhe Shqipërisë, dhe në mënyrë më të gjerë, ndërmjet shqiptarëve dhe popullit hebre.



PRODUKSIONIN KINEMATOGRAFIK "MBJELLJA E PEMËVE"

Banka Amerikane e Investimeve mbështet "Mbjellja e Pemëve", një produksion që të kthen pas në periudhën e errët të komunizmit, ku trajtohet historia prekëse e një nëne dhe vuajtjet e saj për të gjetur vendin ku prehet i biri.




SHKODRA JAZZ AND SWING NGJYROSE ME RETRO

ABI Bank mbështeti Shkodra Jazz and Swing një veprimtari e mbajtur në datat 29-30 maj në qendër të djepit të kulturës, në një atmosferë retro dhe nën tingujt e muzikës jazz dhe swing.



MARIZA DHE QYTETI

Banka Amerikane e Investimeve, sponsor i përgjithshëm i Mariza dhe Qyteti, një koncert recital kush-tuar Tiranës sonë të bukur, sjellë pranë publikut shqiptar nga Mariza Ikonomi.



"SHQIPËRIA NË ART" E AUTORIT FERID HUDHRI

Enciklopedia e autorit Ferid Hudhri, "Shqipëria në Art", tashmë vjen e përkthyer në gjuhën angleze "Albanians in Art", e cila paraqitet si një enciklopedi e kujtesës figurative për historinë, kulturën dhe trashëgiminë kombëtare. Enciklopedia sjell një histori të shkurtër të artit tonë dhe Shqipërinë nëpërmjet artistëve të huaj e atyre shqiptarë. Banka Amerikane e Investimeve mbështeti publikimin e kësaj vepre, që tashmë ndodhet në duart e publikut.



TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Banka Amerikane e Investimeve një mbështetëse besnike e artit dhe vlerave kulturore, kësaj here si sponsor i përgjithshëm i Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor. Një mbështetje që vijoi edhe gjatë periudhës së vështirë të pandemisë, duke u qenë pranë artistëve e duke mundësuar vazhdimësi të shfaqjeve me krijimtarinë më të mirë të repertorit shqiptar për të gjithë artdashësit. ABI ka mbështetur gjatë kësaj periudhe edhe rinovimin e ambienteve të brendshme, si dhe investime në infrastrukturën artistike.



NDËRTIMIN E FUSHAVE TË TENISIT NË SHKOLLËN "PETRO NINI LUARASI"

Nxënësit e shkollës "Petro Nini Luarasi" në Tiranë dhe i gjithë komuniteti, kanë fushat e tyre të tenisit, të cilat u mundësuan falë mbështetjes së Bankës Amerikane të Investimeve.



RESTAURIMIN E KISHËS SË SHËN ATHANASIT NË VOSKOPOJË

Një tjetër mbështetje e rëndësishme nga Banka Amerikane e Investimeve në mbrojtje të monumenteve të kulturës, ishte restaurimi i kishës së Shën Athanasit në Voskopojë. Projekti i financuar, parashikoi restaurimin e kupolave, të çatisë dhe strehës me dekor.




FESTA E BIRRËS

Banka Amerikane e Investimeve, sponsor i përgjithshëm i Festës së Birrës në Korçë, evenimentit më të madh festiv në vendin tonë.



"ROCK THE DICTATOR" NGA RENIS GJOKA

ABI Bank mbështetës i "Rock the Dictator", koncertit më të fundit televiziv nga Renis Gjoka, i ndarë në 3 akte. Koncerti që zhvillohet në vilën e ish-diktatorit Enver Hoxha, ndërthur historinë me muzikën, me interpretime nga artistët më të dashur të ekranit shqiptar.



LOVA FEST

Banka Amerikane e Investimeve sponsor i përgjithshëm i Lova Fest; një organizim emocionues që ndërthur sportin, aventurën dhe muzikën, me pamjet fantastike që bredgeti i jugut ofron.



FESTIVALI BALLKANIK I FILMIT DHE KULINARISË

Banka Amerikane e Investimeve, sponsor i përgjithshëm i edicionit të 11-të të Festivalit Ballkanik të Filmit dhe Kulinarisë në Pogradec; një ndërthurje e artit dhe kulinarisë në Odeonin e bukur të Pogradecit.



PORTO PALERMO FESTIVAL

Banka Amerikane e Investimeve, sponsor i përgjithshëm i Porto Palermo Festival nga Olen Çezari, me pjesëmarrje të artistëve të mëdhenj shqiptarë e italianë, në 5 fundjava të paharrueshme dhe 11 veprimtari muzikore, në vendin ku shkrihet historia me kulturën e muzikës.



SPORT KLUB STUDENTI

Banka Amerikane e Investimeve për të pestin vit radhazi, mbështet Klubin Sportiv "Studenti". Një nga bashkëpunimet më të suksesshme të ABI Bank. Së bashku për një të ardhme të shëndetshme!

Rrjeti i Degëve

Rrjeti i ATM-ve



QYTETI	EMRI I DEGES	ADRESA
Berat	Dega Berat	Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori
Durrës	Dega Durrës	Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët, pallati i ri në Sheshin Pranvera
Elbasan	Dega Elbasan	Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11 nëntori", Godina 38/1
Fier	Dega Fier	Lagjja "Konferenca e Pezës", Sheshi Fitorja
Gjirokastrë	Dega Gjirokastrë	Lagjja "18 Shtatori"
Kavajë	Dega Kavaje	Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3
Korçë	Dega Korçë	Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2
Lezhë	Dega Lezhë	Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi Qendror, përballë Hotel Liss
Lushnjë	Dega Lushnjë	Shëtitorja Kongresi i Lushnjes (pranë Postës Shqiptare)
Pogradec	Dega Pogradec	Rr. "Rreshit Çollaku", (perballë Hotel Turizmit)
Sarandë	Dega Sarandë	L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50, (pranë Kishës Ortodokse)
Shkodër	Dega Shkodër	L. "Vasil Shanto". Rr. 13 Dhjetori, Nr. 270
Tiranë	Dega Qendrore	"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1, Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi Postar 1001
Tiranë	Dega "Samos Tower"	Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3, Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Bajram Curri"	Blv. "Bajram Curri", përballë Nishrakut, Zona Kadastrale 8260
Tiranë	Dega "Qendra Pajtoni"	Autostrada Tiranë - Durrës, km 1, Godina "Pajtoni Business Center"
Tiranë	Dega "Komuna e Parisit"	Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H 13, Njesia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Rruga e Dibres"	Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, përballë Vila Gold
Tiranë	Dega "Sheshi Shtraus"	Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus
Tiranë	Dega "21 dhjetori"	Rr. "Frosina Plaku", Nr.2
Vlorë	Dega Vlorë	Blv. "Ismail Qemali", Parku Rinia

QYTETI	EMRI I ATM	ADRESA
Berat	Dega Berat	Blv. Kryesor, Lagjja 28 Nëntori
Durrës	Dega Durrës	Lagjja Nr.11, Rruga Dëshmorët, pallati i ri në Sheshin Pranvera
Durrës	ATM "Blv. Dyrrah"	Bulevardi kryesor "Dyrrah"
Durrës	ATM "Spitali rajonal"	Spitali Rajonal Durrës, Rr. "Aleksandër Goga"
Durrës	ATM "Shkozet"	Lagjja 14, Rr. "Tirana", Shkozet
Elbasan	Dega Elbasan	Lagjja Luigj Gurakuqi, Rr. "11 nëntori", Godina 38/1
Fier	Dega Fier	Lagjja "Konferenca e Pezës", Sheshi Fitorja
Gjirokastrë	Dega Gjirokastrë	Lagjja "18 Shtatori"
Kavajë	Dega Kavajë	Bulevardi Kryesor, Lagjja nr. 3
Kavajë	ATM "Luz i vogël"	Fshati Luz i vogël, pranë Komunës
Korce	Dega Korce	Rr. "Sotir Gura", Nr.1, Lagjja 2
Korce	ATM "Voskopojë"	Fshati Voskopojë, Qendër
Lezhe	Dega Lezhe	Blv. "Gjergj Fishta", Sheshi Qendror, përballë Hotel Liss
Lezhe	ATM Shengjin	Kompleksi Rafaelo, Shengjin
Lushnje	Dega Lushnje	Shëtitorja Kongresi i Lushnjes (pranë Postës Shqiptare)
Pogradec	Dega Pogradec	Rr. "Rreshit Çollaku", (perballë Hotel Turizmit)
Sarandë	Dega Sarandë	L. 1, Rr "Skenderbeu", Nr. 50, (pranë Kishës Ortodokse)
Shkodër	Dega Shkodër	L. "Vasil Shanto". Rr. 13 Dhjetori, Nr. 270
Tiranë	Dega Qendrore	"Rruga e Kavajës", Nd.27 H.1, Njësia Bashkiake Nr.10, Kodi Postar 1001
Tiranë	Dega "Samos Tower"	Rr. "Ismail Qemali", Nd.20 H.3, Njësia Bashkiake Nr.5, Kodi Postar 1019
Tiranë	Dega "Bajram Curri"	Blv. "Bajram Curri", përballë Nishrakut, Zona Kadastrale 8260
Tiranë	Dega "Qendra Pajtoni"	Autostrada Tiranë - Durrës, km 1, Godina "Pajtoni Business Center"
Tiranë	Dega "Komuna e Parisit"	Rr. "Medar Shtylla", Nd.49,H 13, Njesia Bashkiake Nr. 5,
Tiranë	Dega "Rruga e Dibres"	Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, përballë Vila Gold
Tiranë	Dega "Sheshi Shtraus"	Rr. Qemal Stafa, Sheshi Straus
Tiranë	Dega "21 dhjetori"	Rr. "Frosina Plaku", Nr.2
Tiranë	ATM "Kombinat"	Rr Llazi Miho
Tiranë	ATM "Sky Tower"	Rr. "Ibrahim Rugova", Nr.5, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019
Vlorë	Dega Vlorë	Blv. "Ismail Qemali", Parku Rinia
Vlorë	ATM "Riviera"	Blv. "Ismail Qemali", L. Pavarësia (pranë QTU Riviera)